



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Kuvendi

P R O J E K T L I G J

Nr._____/2019

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.7643,
DATË 2.12.1992, “PËR INSPEKTIMIN SANITAR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.7643, datë 2.12.1992, të ndryshuar, bëhen ndryshimet dhe shtesat, si më poshtë vijon:

Neni 1

Kudo në përmbajtjen e ligjit, fjalët “... inspektorati që mbulon fushën e shëndetit ...” zëvendësohen me “... struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit ...” dhe emërtesa “Drejtoria e Shëndetit Publik” zëvendësohet me fjalët “... Struktura përgjegjëse për shëndetin publik ...”.

Neni 2

Në nenin 1/1, pikat 5 dhe 6 shfuqizohen.

Neni 3

Në nenin 2, pas paragrafit të parë shtohet pragrafi, me këtë përmbajtje:

“Bën përjashtim nga ky ligj inspektimi sanitar në fushën e ushqimit dhe ushqimit për kafshë, inspektimi i cili do të bëhet nga institucioni përgjegjës për kontrollin zyrtar të ushqimit dhe ushqimit për kafshë ...”.

Neni 4

Në nenin 10 bëhen këto ndryshime:

a) Paragrafi i parë ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit është përgjegjëse për kontrollon dhe zbatimin e ligjeve e të akteve nënligjore sanitare dhe pajis me akt miratimi higjieno-sanitar subjektet në sektorët publikë dhe jopublikë, sipas përcaktimeve të këtij neni.”.

b) Nënndarja e parë, pas paragrafit të parë, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- në objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve të të gjitha llojeve, përjashtuar objektet e prodhimit, të ruajtjes, të magazinimit, të transportimit e tregtimit të produkteve ushqimore.”.

Neni 5

Neni 12 shfuqizohet.

Neni 6

Në nenin 13 bëhen këto ndryshime:

a) Në shkronjën “c”, fjalët “... si dhe analizën e hazardëve dhe kontrollin në pikat kritike në të gjithë zinxhirin për prodhimin e produkteve ushqimore.” hiqen.

b) Shkronja “ç” shfuqizohet.

Neni 7

Neni 16 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 16

Struktura përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit, me miratimin e prokurorit, hyn në çdo kohë në ambiente private, përfshirë edhe banesat, kur ka të dhëna e njoftime për ushtrimin e veprimtarive që rrezikojnë shëndetin e njerëzve, si dhe pa akt miratimi higjieno-sanitar, dhe merr masat e nevojshme, sipas legjislacionit në fuqi.”.

Neni 8

Nënndarja e parë, e nenit 19, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“- prodhimin, ruajtjen, transportimin, tregtimin e produkteve kozmetike në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në legjislacionin përkatës dhe normat sanitare.”.

Neni 9

Neni 20 shfuqizohet.

Neni 10

Në nenin 26 bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Pikat 2, 3, 5 dhe 12 shfuqizohen.
- b) Pikat 4 e 14 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“4. Papastërtitë personale e të mjeteve të punës në objektet e përcaktuara në nenin 10, të këtij ligji.

14. Mosmarrja e aktmiratimit prej strukturave përgjegjëse për inspektimin në fushën e shëndetit nga subjektet e përcaktuara në nenin 10, të këtij ligji.”.

Neni 11

Në pikën 4, të nenit 27, bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

- a) Në nënndarjen e parë hiqen numrat “2” dhe “3”.
- b) Në nënndarjen e dytë hiqet numri “12”.
- c) Në nënndarjen e tretë hiqet numri “5”.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

GRAMOZ RUÇI